



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 72

Prishtinë, më 26.03.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Danush Ademi dhe Rasim Demiri.

Përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së: Agim Çeku, ministër, Kadri Kastrati, gjenerallejtënant, Shkelzen Sylaj, sekretar i Përhershëm në MFSK-së, Kevin Lynch, drejtor i ekipit të këshilltarëve të NATO-s, Steve Warnsadt, zv. drejtor i ekipit të këshilltarëve të NATO-s.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha-OSBE, Dhurata Kryeziu-OSBE, Visar Rushiti- GAP, Skender Perteshi, QKSS dhe Lejla Selimi, OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Raportimi i Ministrit të FSK-së, z. Agim Çeku

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Raportimi i ministrit të FSK-së z. Agim Çeku

Kryetari i Komisionit- Njoftoi se në këtë takim është paraparë të ftohet në Komision, ministri i FSK-së, z. Agim Çeku, për raportim të rregullt, bashkë me bashkëpunëtorët e tij. Nga raporti vjetor i Ministrisë së FSK-së, i cili është vlerësuar si e arritur nga ana e Komisionit në bazë të objektivave të përcaktuara dhe të arritura.

Në këtë takim duam të dimë zhvillimet e mëtutjeshme të FSK-së, gjendjen momentale, objektivat e FSK-së dhe Ministrisë së FSK-së. Fjalën ia kaloj z. Agim Çeku, ministër i FSK-së.

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Raportimin në Komision e konsiderojmë një vlerë demokratike për llogaridhënie ndaj Parlamentit dhe qytetarëve për zhvillimet në FSK- së, dhe se transparenca është parim i punës sonë.

Pasi jam ftuar të raportojë për aktivitetet aktuale të FSK-së dhe objektivat për vitin 2013, theksoj që FSK-ja është duke vazhduar punën për përmbushjen objektivave dhe prioritetëve të përcaktuara nga ligjet në fuqi, si dhe ato të ministrit.

Aktivitetet me të cilat merret Ministria e FSK-së, në baza ditore janë: edukimi i oficerëve dhe nënoficerëve, që aktualisht janë 33 oficerë në shkollim jashtë vendit. Në Britani të Madhe janë në trajnim katër mujor dy gjeneralë dhe dy kolonelë, ndërsa dy pjesëtarë të FSK-së, të gjinisë femërore janë në Akademinë Ushtarake të SANTROS. Gjithashtu vazhdon shkollimi i 305 pjesëtarëve të FSK-së për oficer dhe nënoficer në shkolla të ndryshme, si dhe është duke u bërë trajnim i njëjësive, si dhe kemi ekipin nga Turqia që janë të kyçur në nivel kompania në Brigadën e Reagimit të Shpejtë, ekipi nga Britania e Madhe, instruktor nga SHBA-ja, Garda e Ajovës.

Sapo ka përfunduar kursi për Lider Luftarak, është në ngritje kori i nënoficerëve, vazhdimisht jemi duke e mbajtur gatishmërinë operationale dhe kemi ekupe në çdo kazermë që mund të reagojnë në bazë të nevojave. Zhvillohen operatione ditore, siç është deminimi i mjeteve të pashpërthyer. Ndërsa në kohën e vërshimeve në operatione të kërkim shpëtimit janë realizuar operatione të tilla në rajonin e Klinës, i ofrohet ndihmë e vazhdueshme autoriteteve civile.

Jemi të preokupuar me rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, dhe në kuadër të këtij procesi edhe FSK-ja duhet të përfshihet. Aktualisht po synojmë që në kuadër të FSK-së të përfshihen edhe pjesëtarët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë, në mënyrë që përbërja e FSK-së të jetë nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Për këtë qëllim është duke u zhvilluar fushata për sensibilizimin e komuniteteve që të jenë pjesëtarë të FSK-së, ndërsa përfaqësimi i komunitetit serb është i vogël dhe shpresojmë që gjatë kësaj fushate të rritet ky numër.

Tutje njoftoi për projektin e NATO-s, “ Ndërtimi i Integritetit” i cili financohet nga Qeveria norvegjeze, projekt i cili zhvillohet në të gjitha vendet e rajonit. Gjithashtu janë duke u zhvilluar raporte dhe marrëdhënie me vende të ndryshme duke implementuar marrëveshjet e bashkëpunimit.

Jemi në kontakt të vazhdueshëm me NATO-n dhe në prite të vendosjes së raporteve në të ardhmen. Në muajin prill do të realizohet vizita e ministrit të FSK-së, në selinë e NATO-s, dhe konsiderojmë se shumë shpejt do të ndryshojë formati i raportit të FSK-së dhe NATO-s.

Për vitin 2013 janë përcaktuar gjashtë prioritete:

1. Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë operacionale, si dhe bërja e FSK-së forcë e vetëqëndrueshme.
2. Bërja e FSK-së forcë e besueshme, aktive e dukshme dhe e dobishme për qytetarët e Kosovës dhe për rajonin.
3. Bërja e FSK-së forcë për të mirë në rajon.
4. Bërja e FSK-së forcë e zbarkueshme jashtë vendit.
5. Evoluimi i FSK-së në një forcë në bazë të rekomandimeve të rishikimit strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe
6. Bërja e FSK-së partneri besueshëm i NATO-s, SHBA-së dhe vendeve të BE-së.

Ndërsa sa i përket pyetjes se çka pritet dhe çfarë parashohim që do të ndodh këtë vit, konsiderojmë se sa i përket prioritetit të parë, bashkë me Oficerët e Gardës së Ajovës, janë zhvilluar masat për lehtësimin dhe mbajtjen e gatishmërisë operacionale. Nivelet e gatishmërisë vlerësohen në katër nivele dhe në bazë të kësaj vlerësojmë se në çfarë gatishmërie janë njësitet.

Jemi duke zhvilluar trajnime të vazhdueshme në nivel të Batalionit, ndërsa një risi e cila synohet të realizohet këtë vit është ngritje e Qendrës Rajonale të Kërkim-Shpëtimit, projekt i mbështetur nga SHBA-ja, është bërë përzgjedhja e 120 pjesëtarëve për këtë kompani dhe identifikimin e pajisjeve dhe trajnimeve. Pritet realizimi i një trajnimi në Slloveni, ndërsa në rast të mos realizimit të këtij trajnimi atje do të vijë ekspert nga SHBA-ja dhe trajnimi do të realizohet në Kosovë. Gjithashtu do të realizohet një Ushtrim Rajonal Fushor në Shqipëri, gjithashtu do të kemi Qendrën Trajnuese, i cili është një aset të cilin Kosova është duke ua ofruar vendeve të rajonit.

Në mbështetje të SHBA-së janë duke u zhvilluar kapacitetet e “Asgjësimit të Mjeteve Improvizuese Eksplozive” dhe se ky njësit do të jetë i zhvilluar me karakter rajonal. Ndërsa fokus tjetër gjatë vitit 2013, është përmirësimi i kulturës për përgatitjen fizike të ushtarëve dhe vendosja e standardeve dhe se për këtë qëllim kemi pasur trajner nga Britania e Madhe.

Ndërsa për prioritetin e dytë të përcaktuar për vitin 2013, janë projekte të cilat janë në realizim e sipër, siç është integrimi i minoriteteve, përgatitja e skemës së vëzhguesve të rinj, organizimi i kampeve për të rinj që tregojnë interes. Gjithashtu janë duke u bërë programe për qëllim të vetëdijesimit nëpër shkolla për mjetet e pa shpërthyer, si dhe jemi në mbështetje të autoriteteve civile.

Është duke u bërë përpjekje për ndërtimin e identitetit kombëtar për ndërtimin për krijimin e Klubit të Oficerëve dhe Ushtarakëve dhe Muzeun Ushtarak, gjithashtu në bashkëpunim me KFOR-in kemi synim sjelljen e disa armëve dhe eksponateve që janë përdorur gjatë luftës dhe që do të sillen nga Shqipëria në Kosovë, pjesë e këtij prioriteti do të jetë edhe ndërtimi i ekepeve sportive të FSK-së.

Për prioritetin e tretë, jemi të vetëdijshëm për perceptimin e disa vendeve të rajonit për FSK-në, për këtë qëllim në vazhdimësi jemi duke e promovuar dhe vërtetuar vetën si forcë për të mirën e rajonit dhe për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit. Në vazhdimësi marrim pjesë në takimet në kuadër të Kartës së Adriatikut, në nivel të ministrave dhe Shefave të Shtabit dhe se këtë vit kemi qenë të ftuar në Bosnjë dhe Hercegovinë në takimin e Shefave të Shtabit, ku ka marrë pjesë përfaqësuesi i FSK-së.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal kemi filluar iniciativën që në rajon të bëhet marrëveshja mes Ministrive të Mbrojtjes për ndihmën e ndërsjellë në rastet e emergjencave, mbështetës i kësaj iniciative është Komanda Amerikane për Evropë.

Për vitin 2013 janë të planifikuara tre ushtrime rajonale, në Shqipëri i quajtur “Reagimi i përbashkët 2013” i organizuar nga Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, në Maqedoni, i organizuar nga Komanda Amerikane për Evropë dhe ushtrimi i tretë do të jetë në Maqedoni, kampi i kadetëve.

Ndërsa sa i përket prioritetit të katërt, ku në kuadër të kësaj është proceduar në Kuvend Projektligji për Dërgimin e FSK-së jashtë vendit, dhe në të njëjtën kohë jemi duke zhvilluar aktet nënligjore që e mbështesin këtë ligj. Në bashkëpunim me Gardën e Ajovas me standarde të larta janë zhvilluar të gjitha procedurat që duhet të kaloj çdo njësit para zbarkimit, duke filluar nga ekzaminimi mjekësor, përgatitja psikologjike, sigurimet e ndryshme shëndetësore.

Risi e këtij viti është se presim të jemi pjesëmarrës në shkollat e NATO-s, gjë që deri më tani nuk ka pasur gatishmëri që FSK-ja të jetë pjesëmarrëse. Në vazhdimësi jemi duke i ofruar kapacitetet tona ekzistuese në operacione paqeruajtëse.

Për prioritetin e pestë, në këtë proces jemi bashkë me ekipin e Pentagonit dhe ekipi i NATO-s, proces i cili është duke shkuar në harmoni të plotë me aktet ndërkombëtare.

Në muajin qershor të këtij viti, do të dalim me një raport preliminar, me produktet e nxjerra. Në këtë fazë është duke u bërë identifikimi i kapaciteteve dhe aftësive të nevojshme që i nevojën FSK-së dhe identifikimin e zbrazëtirave dhe se ky proces na dërgon drejt kërkesave substanciale për aftësitë e reja që nuk i ka FSK-ja dhe se nga ky proces FSK-së do t’i jepet një rol i ri dhe detyra të reja. Nga ky proces i rishikimit të sektorit të sigurisë, do të përcaktohen prioritetet, veprimet në vitet në vijim, dhe pas muajit qershor do të fillohet me draftimin e ligjeve të reja.

Dhe prioriteti i gjashtë, në vazhdimësi krijojmë partneritet dhe se deri tani janë realizuar njëmbëdhjetë bashkëpunime dhe gjatë këtij viti priten të realizohen marrëveshje bashkëpunimi me Slloveninë, Hungarinë, Italinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, gjithashtu bashkëpunim produktiv bëhet edhe me Gardën e Ajovas.

Më tre qershor, do të jetë “*Defence Coordination Meeting Room*”, ndihma e SHBA-së për Kosovën për sektorin e sigurisë, takim i cili do të jetë në nivel ministrash, me drejtuesit e Pentagonit dhe Komandës Evropiane të Ushtrisë, ku në mënyrë afatgjate do të përcaktojmë mbështetjen e SHBA-së për Kosovën.

NATO-ja, ka ndihmuar FSK-në në ngritjen e kapaciteteve të saj, dhe për këtë qëllim ka dërguar dy ekipe, ekipin këshillues të NATO-s në Ministrinë e FSK-së dhe ekipin ushtarak i cili është në kuadër të FSK-së, të cilët kanë ndihmuar arritjen e kapaciteteve të plota operationale.

Takimi i cili do të realizohet në prill të këtij viti në selinë e NATO-s, do të kemi mundësi të diskutojmë se çfarë do të bëhet me ekipet e dërguara për mbështetje dhe roli i tyre në

nivel të organizimit të Ministrisë dhe FSK-së. Propozimi ynë është që të kemi tri nivele të bashkëpunimit, të vazhdohet me një ekip të NATO-s, i udhëhequr nga një zyrtar civil dhe të jetë në kuadër të Ministrisë së FSK-së, të kepi një ekip që do të jetë i lidhur me stafin civil ndërkombëtar dhe një ekip ushtarak ndërlidhës dhe këshillëdhënës i dislokuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të ketë lidhje me zinxhirin komandues ushtarak të NATO-s. Ndërsa me KFOR-in të ketë bashkëpunim në kuadër të aktiviteteve ditore, trajnimeve, ushtrimeve të përbashkëta.

Ky është propozim nga ana e Ministrisë së FSK-së, dhe mendojmë se kjo do të realizohet, kjo pasi synojmë të kemi raporte të vazhdueshme dhe të përhershme me NATO-n si pjesë e Partneritetit për Paqe.

Kryetari i Komisionit- Njoftoi se në Komision është amendamentuar Projektligji për dërgimin e FSK-së jashtë vendit, i cili do të procedohet në seancë, gjithashtu njoftoi për përfundimin e draftimit të Projektligjit për Komisionerin për Mbrojtje dhe Polici dhe se zhvillime të tilla do të mundësojnë funksionimin e FSK-së dhe vlerësimin nga ana e NATO-s për FSK-në.

Rexhep Selimi- Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në kuadër të funksionit mbikëqyrës që ka, krahas kësaj ka mbështetur në vazhdimësi Ministrinë e FSK-së, theksoi Projektligjin për Dërgimin e FSK-së jashtë vendit i cili do të ndihmojë funksionimin e FSK-së, dhe realizimit të prioriteteve të përmendura nga ministri Çeku:

4. Bërja e FSK-së forcë e zbarkueshme jashtë vendit.

6. Bërja e FSK-së partner kredibil dhe të besueshëm të NATO-s, SHBA-së dhe vendeve të BE-së.

Është për tu vlerësuar krijimi i Qendrës Rajonale për Kërkim-Shpëtim dhe se kjo është një vlerë që Kosova shërben për krijimin e njëjësive rajonale dhe kjo është një arritje e FSK-së.

A janë plotësuar prioritetet e caktuara në vitin 2012, me theks të veçantë përmbushja e kapaciteteve të plota operacionale?

Lidhur me Prioritetin e pestë dhe gjashtë, në kuadër të rishikim strategjik të sektorit të sigurisë, kur përmendët evoluimin, është fjala për evoluimin e statusit të FSK-së në ushtri të Republikës së Kosovës, nëse jo në ushtri në çka?

A e parashihni që në zhvillimet e ardhshme FSK-ja të zhvillohet në ushtri të Kosovës, nëse po, kur? Nëse jo, pse?

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Pas analizimit të rezultateve për vitin 2012, ajo çfarë është varur nga ministria është arritur me sukses. Nuk është arritur aprovimi i kapaciteteve të plota operacionale. Nga ana e ministrisë është kërkuar realizimi i këtyre kapaciteteve, por në anën tjetër NATO-ja ka qenë e zënë me operacione të ndryshme në Libi dhe Afganistan, gjithashtu për marrjen e vendimeve në NATO, duhet një konsensus i plotë, pasi dihet që katër vende anëtare të NATO-s, nuk e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës. Në vazhdimësi jemi pjesë e takimeve të NATO-s, por në cilësinë e të ftuarve, çështje që nuk varen nga ne, por nga Iniciativat Rajonale, ku anëtare në to është Serbia dhe në vazhdimësi bëhen bllokada karshi Kosovës. Presim që nga

Marrëveshja teknike e arritur të respektohet dhe do të mundësohet anëtarësimi i plotë i shtetit të Kosovës në këto Iniciativa Rajonale.

Ndërsa sa i përket emërimit të FSK-së, në kuadër të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë qëllimi është krijimi i një sigurie të përhershme. Pakoja e Ahtisarit thekson se pas pesë viteve të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, 2008, sektori i sigurisë duhet të rishikohet.

Qëllimi është që shteti i Kosovës të ketë institucionet dhe të ketë një forcë reale që të mos jetë e përkohshme, që të mund të përballojë kërcënimet dhe rreziqet e mundshme për vendin dhe qytetarët dhe i përballueshëm për buxhetin e Kosovës, pasi i vetmi institucion ende i pa përfunduar në ndërtimin e infrastrukturës shtetërore është FSK-ja dhe se qëllimi i këtij procesi është përmbyllja e kësaj detyre, për konsolidimin e strukturës shtetërore.

Ndërsa për strukturën, kapacitetin e FSK-së në të ardhmen është Parlamenti i Kosovës që vendos, proces i cili do të përcillet edhe me ndryshime kushtetuese, plotësim ndryshim të ligjeve ekzistuese dhe se këto do të kalojnë përmes Parlamentit dhe në bazë të këtyre ligjeve do të veprojnë FSK-ja. Prandaj nuk ka dilema se ku na çon procesi i rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, pasi për strukturën, detyrat konkrete do të diskutohen varësisht se sa mund të përballohen dhe kemi nevojë.

Qëllimi është arritja e kapaciteteve që të mos kemi mangësi dhe të jemi të aftë t'i përballojmë kërkesat dhe sfidat e sigurisë.

Fatmir Xhelili- Vlerësojmë përkushtimin dhe qasjen serioze për zhvillimin e FSK-së, e cila është ndërtuar në një forcë moderne për përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Ndërsa kam dy pyetje për ministrin, Çeku. Në procesin e privatizimit të pronave, a është bërë identifikimi i ndonjë lokacioni që do të jetë i nevojshëm për ushtrimet tekniko-operative për FSK-në në të ardhmen, në mënyrë që në kohë të bëhet planifikimi nga Qeveria e Kosovës, ose Kuvendi i Kosovës?

Sa jeni duke investuar në segmentin inteligjent, apo kundër inteligjent në kuadër të FSK-së dhe sa jeni të ndihmuar me pajisjet teknologjike për zhvillimin e këtij segmenti, si dhe për edukimin e kuadrove, në mënyrë që FSK-ja të bazohet në informacione burimore dhe parashikuese?

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Në bazë të skenarëve parashohim që të kemi numër dhe shtrirje më të madhe të FSK-së, parashikojmë të kemi edhe komponentin e Gardës Kombëtare, Komandën e Njësisë Rajonale, si dhe infrastrukturë shtesë. Në kuadër të FSK-së janë themeluar shtatë grupe punuese, siç është Grupi i Infrastrukturës dhe në kuadër të këtij aktiviteti oficerët janë duke bërë identifikimin e objekteve që ka pasur në shfrytëzim FSK-ja.

Gjithashtu është krijuar një grup i përbashkët me Policinë e Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme me qëllim që disa objekte të përdorën bashkërisht dhe shkëmbimin e disa objekteve pasi qëllimi është të shtrihemi në gjithë Kosovën. Ndërsa sa i përket lokacionit për ushtrime fushore, është identifikuar një i tillë në zonën e Rahovecit dhe se kjo kërkesë i është drejtuar Qeverisë së Kosovës në mënyrë që kjo hapësirë t'i caktohet FSK-së.

Ndërsa sa i përket mekanizmit të informimit, në listën e kapaciteteve që i nevojiten FSK-së radhitet edhe Kontrolli Kompjuterik i Inteligjencës(KKI), ndërsa sa i përket vlerësimit të kërcënimeve nuk kemi kërcënime të identifikuar pasi këto janë të pa parashikueshme,

por theks të veçantë do t'i japim Inteligjencës dhe se kapacitetet në kuadër të FSK-së do të jenë të gatshme të zhvillojnë të ashtuquajtura Operacione të Udhëhequra në bazë të Inteligjencës” në mënyrë që si çdo vend edhe Kosova të ketë shërbimin inteligjencë në kuadër të FSK-së.

Planifikojmë të kemi njësitin e Inteligjencës, Ekonomizimit dhe Vëzhgimit, si dhe parashikojmë të kemi kapacitetet të operacioneve të Forcave Speciale dhe se sistemi i Informacionit, Parandalimit dhe reagimit të shpejtë janë parime që do ta udhëheqin forcën tonë.

Ganimete Musliu- Përgëzoj të arriturat e paraqitura në raportimin e ministrit, z. Çeku, për besueshmërinë dhe vlerën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në opinion. Gjithashtu konsideroj se në kuadër të gradimeve në FSK, në bazë të meritokracisë të ketë edhe nga radhët e gjinisë femërore për gradën gjeneral, pasi do të ishte një mirënjohje për të gjitha femrat që kanë qenë pjesëtare të UÇK-së.

Ndërsa, pyetja drejtuar ministrit është: Nga raportimi juaj z. ministër, u përmend edhe ngritja e një Muzeu Ushtarak, ndërsa ne kemi Muzeun Ushtarak në Likovc, për këtë arsye desha të dijë, ku do të jetë vendndodhja e këtij muzeu? Ndërsa në rast të krijimit të një muzeu të veçantë, cili do të jetë relacioni i tij me Muzeun në Likovc?

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Nga ana e Ministrisë së FSK-së është vlerësuar është vlerësuar nevoja e pasjes së një Muzeu Ushtarak, për këtë arsye kemi bërë kërkesë Qeverisë së Shqipërisë që në kuadër të asgjësimit të armatimit të tepërt si kërkesë e NATO-s, t'i ndajë disa eksponate të çdo lloj armatimi që posedojnë dhe t'i sjellin në Kosovë.

Ndërsa vendosja e këtij muzeu është çështje e strukturës së ardhshme të FSK-së, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa vendimi për vendndodhjen e muzeut do të merret nga Qeveria e Kosovës. Për këtë qëllim kemi nevojë për donator, por si Ministri do të kontribuojmë në sigurimin e këtyre eksponateve.

Goran Marinković- Konsideroj se Ministria e FSK-së ka kaluar sfidat në procesin e konsolidimit të saj, gjithashtu u theksua se u kushtohet rëndësi shkollimit të pjesëtarëve të FSK-së. Gjithashtu u theksua se do të ketë një përparim sa i përket përfshirjes së komuniteteve që jetojnë në Kosovë në kuadër të FSK-së.

Si e shihni ju z. ministër, përfaqësimin e komunitetit serb në nivelin komandues, në mënyrë që mos të mbetet vetëm në nivelin e thjeshtë?

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Jemi serioz kur themi se FSK-ja do të jetë institucion shumetnik dhe të pasqyrohet përbërja e shoqërisë. Jemi të vetëdijshëm që edhe në stafin komandues duhet të kemi pjesëtarë nga komunitete që jetojnë në Kosovë dhe për këtë qëllim në Maqedoni janë dërguar katër Kadet në Akademinë Ushtarake, dy prej tyre janë nga komuniteti serb ndërsa dy të tjerët nga komuniteti boshnjak, projekt i cili realizohet në bazë të marrëveshjes që kemi me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë e cila do të vazhdoj për tri vjet.

Këta kadet të shkolluar do të kenë mundësi për avancim në karrierë në kuadër të FSK-së. Në vitet e ardhshme do të kemi komponentin rezervë e cila do të rekrutohet në baza territoriale në të gjitha komunat në Kosovë të cilat do t'i kenë strukturat komanduese,

pasi jemi duke investuar që në radhët e FSK-së të jenë të përfaqësuara të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Anton Quni- Në kuadër të FSK-së konsideroj se e rëndësishme është identifikimi i rreziqeve në mënyrë që të përcaktohet misioni, struktura ngritja e njësive të specializuara. A janë identifikuar së paku dhjetë rreziqe që kërcënojnë jetën e qytetarëve të Kosovës dhe pasurinë e tyre? Marrë parasysh këto rreziqe, cilat janë kërkesat që misioni i FSK-së t'u përgjigjet këtyre kresave në mënyrë adekuate?

Si e shihni rolin e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në përpjekjen e përbashkët për ngarkimin e FSK-së me një mision të ri të karakterit ushtarak? Ku dhe si mund t'i parashtrijmë kërkesat tuaja, cili është autoriteti që vendos për të ardhmen e FSK-së? A do të krijohet grup punues që të bëjë vlerësimin e situatës në kuadër të procesit të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, e paraparë sipas pakos së Ahtisarit, dhe a do të jetë e nevojshëm paraqitja e qëndrimeve partiake që përfaqësojmë?

Ministri i FSK-së, z. Agim Çeku- Në kuadër të procesit të rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, është Komiteti Drejtues i udhëhequr nga ana ime dhe është i përbërë nga grupe punuese. Në kuadër të këtyre grupeve punuese është Grupi për Identifikimin e Kërcënimeve dhe Rreziqeve e udhëhequr nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë dhe se nga ana e tij janë bërë identifikimet e rreziqeve të mundshme. Raporti i këtij grupi punues është dokument i klasifikuar, por do të jetë pjesë e raportit përfundimtar.

Pas studimit janë identifikuar dymbëdhjetë skenarë të mundshme se nga çfarë mund të rrezikohet siguria e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Kjo çështje është duke u bërë në bazë të një studimi akademik me ekipet e ekspertëve të cilët kanë punuar në vendet post-komuniste duke i transformuar në ushtri të tipit të NATO-s.

Ndërsa sa i përket rolit të Komisionit në këtë proces, konsideroj se është i rëndësishëm, pasi edhe kryetari, z. Ahmet Isufi është anëtar i Komitetit Drejtues dhe mund të ju informoj për zhvillimet e bëra, dhe se në kuadër të hartimit të legjislacionit për FSK-në është Komisioni ai që bënë amendamentimin e tij.

Gjithashtu konsideroj se propozimet e Komisionit do të merren parasysh nga Parlamenti, për çdo fushë ku nevojitet mbështetja e juaj për FSK-në, dhe se si Ministri jemi të gatshëm të ju njoftojmë për zhvillimet dhe ecurinë e procesit për Rishikim Strategjik të Sektorit të Sigurisë.

Sekretari i Përhershëm në MFSK-së, z. Shkelzen Syla- Njoftoi se nga ana e Ministrisë së FSK-së është miratuar udhëzimi administrativ në bazë së cilit do të implementohet Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe se në kuadër të këtij udhëzimi do të bëhet verifikimi i operatorëve ekonomik që bëjnë shërbime dhe furnizime në Ministrinë e FSK-së dhe në FSK.

Gjithashtu në fazën përfundimtare është edhe Rregullorja për shërbimin e Atasheve, dhe më pas do të bëhet procedimi i saj në Kuvendin e Kosovës, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Ministrinë e Financave.

Kryetari i Komisionit- Në bazë të raportimit të Ministrit, z. Çeku, konsiderojmë se është koha të bëhet rritja e kapaciteteve të FSK-së, si dhe Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë. Prandaj me konsolidimin e FSK-së shteti i Kosovës do të kompletohet me

institucionet e veta, e cila është interes i Kosovës dhe rajonit me synim të paqes, bashkëpunimit dhe integritetit në NATO.

Nga ana e Komisionit do të kenë përkrahjen për bazën ligjore të nevojshme që do të krijoni, prandaj jemi të gatshëm dhe mbështesim zhvillimin e mëtutjeshëm të FSK-së dhe integritetin e vendit në NATO.

Në mbyllje falënderoi ministrin e FSK-së, z. Çeku dhe bashkëpunëtorët e tij për raportimin në Komision.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi